

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

3.02.2023
Ora 10:34

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e elementeve dhe materialeve të logjistikës zgjedhore që do të përdoren në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. A. Tahiraj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike:** **PL (Z. A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Atëherë në seancën e sotme kemi për shqyrtim këto çështje: projektvendimin “Për miratimin e elementeve të disa materialeve të logjistikës zgjedhore, që do të përdoren për zgjedhjet”; projektvendimin ‘Për caktimin e njësive administrative, ku do të krijohen selitë e komisionit të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023”; projektvendimin “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës, që do të përdorin komisionet e zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”; dhe e fundit, projektvendimin “Për miratimin e modeleve të procesverbaleve të administratës zgjedhore, që do të përdoren në zgjedhje”. Këto që nuk e kanë cilësimin e datës janë akte të përgjithshme rregullatore.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e elementeve të disa materialeve të logjistikës zgjedhore.

Z. Y. Merhaj: Duke iu referuar nenit 19.99/115 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet kompetenca e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e modeleve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore, që do të përdoren në zgjedhje, për të pajisur komisionet përkatëse me shenja dalluese, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të miratojë modelet e shenjave dalluese, si dhe të marrë masa për prodhimin e dërgimin e tyre në çdo KZAZ. Në zbatim të përcaktimit të Kodit Zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për të unifikuar praktikën zgjedhore ka përgatitur modelet e shenjave dalluese, përmbajtja dhe eskuzivi i të cilave janë bazuar në nenet e mësipërme dhe në eksperiencën e deritanishme të proceseve zgjedhore. Në projektvendim është përcaktuar sekretari i përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që të hartojnë specifikimet teknike dizajne, të cilat do të aplikohen dhe shpallen për çdo proces zgjedhor. Kjo qasje e re do të lehtësonte procesin e prokurimit dhe të prodhimit të tyre në vijimësi. Bashkëlidhur keni një projektvendim për shqyrtim dhe miratim! Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Komisioner! Këto janë akte që shkojnë në atë që është vijimësia e procesit zgjedhor të këtij viti, kështu që jemi njohur me to dhe do të donim të vinim në dijeni komisionerin vetëm për shkak të volumit të madh të akteve, duke parë edhe detyrimet që ngarkon ligji për sa u përket afateve të miratimit të tyre, të gjejmë të paktën një kohë më të përshtatshme, të themi, për të

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 3.02.2023*

na i vënë në dispozicion, në mënyrë që, me gjithë angazhimet tona tjera, të jemi në koordinim të plotë me ato që janë interesat e subjekteve që mbrojmë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Ju faleminderit! Vërejtja qëndron dhe do të përpiqemi ta korrigjojmë. Të paktën, minimalisht të jenë 24 orë të plota, se, në fakt, jua kanë nisur vetëm dje, nëse nuk gaboj. Ju faleminderit, për mirëkuptimin! Atëherë nëse nuk kemi gjë tjetër në lidhje me përmbajtjen, e miratojmë projektaktin, sipas projektit të paraqitur.

Vendimi nr. 31

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

3.02.2023
Ora 10:38

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e njërive administrative, ku do të krijohen selitë e komisionit të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. A. Tahiraj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike:** **PL (Z. A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: për caktimin e selive të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor.

Z. Y. Merkaj: Duke ju referuar nenit 19, pika 1, shkronjave “b” dhe “n” të Kodit Zgjedhor parashikohen kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të drejtuar dhe mbikëqyrur drejtpërdrejt ose nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve dhe referendumeve. Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor parashikohet krijimi i selive të KZAZ–ve, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë nen. Komisioni rregullator, me vendimin numër 6 të datës 30.11.202, ka miratuar ngritjen e 92 zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 32 të datës 16.12.2020, ka vendosur

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

caktimin e selive të KZAZ-ve për 92 zonat e administrimit zgjedhor, duke u bazuar në shtrirjen dhe relievin gjegjografik të zonave të administrimit zgjedhor, numrin dhe pozicionin gjegjografik të njësive administrative, të përfshira në territorin e zonave të administrimit zgjedhor, lehtësitë logjistike të transportit rrugor, si dhe praktikatat e zgjedhjeve të mëparshme. Në kushtet kur numri dhe territori i zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 janë po ato të miratuara me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të vitit 2020, rrjedhimisht edhe selitë e KZAZ-ve do të krijohen në të njëjtat njësi administrative, sikundër edhe në zgjedhjet e vitit 2021. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 25 nëntor 2022 u është drejtuar bashkive për caktimin e ambienteve që do të shërbejnë si selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Kryetarët e bashkive në vijimësi kanë propozuar ambientet që do të shërbejnë për seli të KZAZ-ve, duke iu referuar adresave të ambienteve e sipërfaqeve përkatëse. Bashkëlidhur kemi një projektvendim për shqyrtim dhe miratim, si dhe në lidhjen nr. 1 ku janë selitë e KZAZ-ve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësues të partive politike lidhur me projektaktin?

Z. A. Kaziaj: Po, i nderuar, zoti kryetar, ky është një akt me karakter shumë të veçantë, të themi, pavarësisht asaj që ishte relacioni i sekretarit të përgjithshëm, lidhur me praktikatat e mëparshme, ku ka pasur vendndodhje selia e ZAZ-ve përkatëse. Fakti është që të mos kemi trajtim privilegjues për disa subjekte dhe diskriminues për disa të tjera. Akti është voluminoz dhe do të donim që ta konsultonim edhe me përfaqësuesit tanë nëpër ZAZ-të përkatëse. Koha e mjaftueshme nuk ka qenë, kështu që, me mirëkuptimin tuaj, në qoftë se ju e konsideroni këtë kërkesë timen dhe brenda afatit të caktuar ligjor, në mënyrë që të

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

mos ju marrim më shumë kohë, që të jemi në rregull me ato që janë përcaktime të ligjit, fakti është që do të na duhet pak kohë.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Atëherë mendoj që kërkesa juaj është e përligjur dhe besoj se deri të martën, ose maksimumi të mërkurën e javës tjetër, ju e keni kohën e mjaftueshme për të bërë verifikimet në terren të objekteve, të cilat, sipas draftit të paraqitur, do të jetë selitë e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor. Dakord. Dhe meqenëse jemi këtu, duhet një kujtesë tjetër për kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në lidhje me masat që ata kanë marrë për ambientet e qendrave të votimit, parë këto në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Ju kemi dërguar edhe më parë një kujtesë në lidhje me këtë çështje, por është mirë që t'ju risjellim edhe një herë në vëmendje, veçanërisht në ato qendra votimi ku ne kemi të identifikuar, sipas të dhënave tona, votues të kësaj kategorie, për aq sa do të jetë e mundur, që të konsiderohet pozitivisht interesi dhe nevoja e kësaj kategorie për t'i patur këto qendra votimi në katet e para minimalisht. Kështu që edhe një kujtesë tjetër, të lutem, Erjon!

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

3.02.2023
Ora 10:42

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës, që do të përdorin komisionet e zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. A. Tahiraj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike:** **PL (Z. A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirë, kalojmë te pika e tretë, që ka të bëjë me dokumentacionin e punës së KZAZ-së.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të kompetencave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për drejtimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratës zgjedhore, përcakton modelet e dokumentacionit të punës, që do të përdoren nga komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Projektvendimi përcakton modelet dhe vendimet e dokumentacionit të punës së komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, në përmbushje të detyrave për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ. Këto modele vendimesh dhe dimensionin e punës

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

janë konfiguruar nga KQZ-ja për t'i ardhur në ndihmë komisionit të zonave të administrimit zgjedhor, duke synuar lehtësinë e punës së tyre. Ky projektvendim përfshin modelet e vendimeve të KZAZ-së, që lidhen me funksionin e vetë KZAZ-së, por edhe me përmbajtjen e përmbushjen e detyrave, në lidhje me funksionimin e komisionit të qendrës së votimit dhe të grupeve të numërimit. Këto modele vendimesh janë: për propozimin e kryetarit të KZAZ-së, për propozimin e zëvendëskryetarit të KZAZ-së; për emërimin e anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit; për emërimin e kryetarit dhe sekretarit të komisionit të qendrës së votimit; për shkarkimin e anëtarëve të grupnumërimit; për njoftimin e policisë për vendosjen e rendit në VNV; për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor dhe të tjera. Gjithashtu, projektvendimi përfshin edhe modele vendimesh të KZAZ-së, që duhen marrë përgjatë shqyrtimit të kërkesave për regjistrimin e komiteteve nismëtare apo kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore, nga koalicionet apo nga zgjedhësit. Në projektvendim janë parashikuar edhe modelet që përdor KZAZ-ja si: libri i protokollit të mbledhjeve, regjistri i vendimeve, regjistri i korrespondencës dhe procesverbalet e konstatimit. Gjithashtu, në këtë projektvendim është parashikuar edhe modeli i vërtetimit për kërkesën e zgjedhësve, nëse emri i tyre është apo jo në listën përfundimtare të zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse. Projektvendimi parashikon edhe miratimin e modeleve të procesverbaleve që KZAZ-ja përdor në funksion të numërimit të votave. Modele mund të përmendim: procesverbalin e vulosjes së kutisë së posaçme me fletët e hedhura gabim në kutinë për kryetar bashkie; procesverbali i vulosjes së kutisë së posaçme për fletët e hedhura gabim në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë; procesverbal konstatimi për votat e hedhura gabim; procesverbal për mbylljen e kutisë për votat të hedhura gabim për kryetarin dhe për këshillin e bashkisë. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim e miratim, si gjithë modelet bashkëngjitur këtij vendimi. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive? Dakord. Atëherë e miratojmë projektvendimin, sipas draftit të paraqitur.

Vendimi nr. 32



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

3.02.2023
Ora 10:45

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e modeleve të procesverbaleve të administratës zgjedhore, që do të përdoren në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. A. Tahiraj, Z. E. Meta**
- **Parti Politike:** **PL (Z. A. Kaziaj)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Pika e katërt dhe e fundit e rendit të ditës është për miratimin e modeleve të procesverbalit të administratës zgjedhore.

Z. Y. Merkaj: Në mbështetje të neneve të Kodit Zgjedhor 99, 100, 115, ku parashikohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e modeleve të procesverbaleve, që do të përdoren në zgjedhje për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, është përgatitur projektvendimi i mësipërm. Në zbatim të përcaktimit të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të unifikuar praktikën zgjedhore ka përgatitur modelet e procesverbaleve, përmbajtja dhe specifikat e të cilave janë bazuar në nenet e mësipërme dhe në eksperiencën e mëparshme zgjedhore. Në projektvendim është përcaktuar se sekretari i përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së do të hartojnë specifikime teknike dizajni,

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.3.02.2023*

të cilat do të publikohen dhe do të shpallen në çdo proces zgjedhor. Për sa më sipër, i paraqitet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtim e miratim projektvendimi, si dhe modeli i procesverbalit bashkëngjitur këtij vendimi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive? Dakord, me draftin e propozuar. Mirë atëherë, e miratojmë projektvendimin, sipas propozimit të paraqitur nga administrata.

Çështje tjera në rend të ditës nuk kemi. Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr. 33